



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 2240 Prot.

Himarë, më 21.07.2020

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL  
LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË  
NË KATEGORINË E MESME DHE E ULËT DREJTUES**

**Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Himarë, Kategoria e pagës III-b**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Himarë** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**1. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Pyjeve dhe Kullotave - Kategoria e pagës III-b**

*Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Të dyja këto procedura është vendosur të jenë të hapura edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të nenit 26/4).*

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)  
aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 31.07.2020**

**LËVIZJE PARALELE**

**Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 05.08.2020**

**NGRITJE NË DETYRË**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

- Organizon dhe drejton punën brenda sektorit, raporton dhe përgjigjet direkt tek Drejtori dhe Kryetari i Bashkisë.
- Organizon, mbikëqyr, koordinon dhe monitoron punën e stafit në varësi.
- Vlerëson, aftësitë dhe performancën e përgjithshme të nëpunësve të sektorit , duke përgatitur vlerësimet me shkrim të rezultateve në punë, gjykon mbi ecurinë e punës dhe vë në dukje fushat në të cilat janë të nevojshme përmirësime.
- Kontrollon të gjitha materialet dhe korrespondencat e hartuara nga punonjësit e sektorit, para paraqitjes për miratim dhe nënshkrim tek Drejtori i Drejtorisë.
- Menaxhon dhe merr masa për mbrojtjen e tokës në territorin brenda ndarjes administrative territoriale të Bashkisë.
- Bashkëpunon dhe shkëmben të dhëna me Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, Ministrinë e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural dhe Institucione të tjera në lidhje me veprimtarinë e sektorit dhe të Drejtorisë.
- Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi të bashkisë, si dhe të kategorive të resurseve të tjera për të gjithë territorin në juridiksion të bashkisë, mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues.
- Këshillon dhe orienton specialistet e zyrës që drejton me qëllim realizimin e sukseshëm të detyrave
- Jep llogari për realizimin e detyrave të ngarkuara si dhe mban përgjegjësi për çdo shkelje.

## **1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-b;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Agronomi, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet*

*të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera, në profesion.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 31.07.2020.***

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **03.08.2019** Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Bashkisë Himarë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Bashkisë Himarë, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave".
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 7501 datë 19.07.1991 "Për tokën " i ndryshuar,
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar nga Ligji Nr. 69/2013, datë 14.02.2003 dhe Ligji 131/2014, datë 02.10.2014
- g) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9948 datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmerisë ligjore të titujve të pronësisë të tokës bujqësore" i ndryshuar me ligjin Nr. 58/2012 dt. 17.05.2012.
- h) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
- i) Njohuritë mbi Ligjin Nr.10263, datë 8.4.2010, "Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara".
- j) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 111/2018 datë 07.03.2019 "Për kadastën"
- k) Njohuritë mbi VKM Nr. 121, datë 17.2.2011, "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë ose bashki"
- l) Njohuritë mbi VKM Nr. 531, datë 21.8.1998, "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.3.2001.

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike

1.6

## **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2

## **NGRITJA NË DETYRË**

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë,*

*Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të vendimit të titullarit por që nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik, neni 26/4).*

2.1

## **KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Agronomi, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera, në profesion.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.

d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 05.08.2020.***

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **12.08.2020** Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Bashkisë Himarë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Bashkisë Himarë, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave".
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 7501 datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar,
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar nga Ligji Nr. 69/2013, datë 14.02.2003 dhe Ligji 131/2014, datë 02.10.2014
- g) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9948 datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmerisë ligjore të titujve të pronësisë të tokës bujqësore" i ndryshuar me ligjin Nr. 58/2012 dt. 17.05.2012.
- h) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
- i) Njohuritë mbi Ligjin Nr.10263, datë 8.4.2010, "Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara".
- j) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 111/2018 datë 07.03.2019 "Për kadastër"
- k) Njohuritë mbi VKM Nr. 121, datë 17.2.2011, "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë ose bashki"
- l) Njohuritë mbi VKM Nr. 531, datë 21.8.1998, "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.3.2001.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultetit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al). <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

**Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse**

**BASHKIA HIMARË**

